

**NË GJYKATËN E QARKUT NË PEJË**

Lënda P.nr.214/11

03 Maj 2012

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Qarkut në Pejë, trupi gjykues i përbërë nga Gjyqtari Malcolm Simmons si Kryetar i Trupit Gjykues dhe Gjyqtari Dariusz Sielicki dhe Lumturije Muhaxheri si anëtar të Trupit Gjykues, dhe Procesmbajtësja Natasa Malesevic, në lëndën penale kundër

1. **Bedri Krasniqi**, i lindur me 10 Shtator 1979 në fshatin Turjakë, Komuna e Pejës, i biri \_\_\_\_\_ dhe nënës \_\_\_\_\_, mbiemri i vajzërisë \_\_\_\_\_, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion hidraulik, i gjendjes së mesme ekonomike, i dënuar me 27 vite burgim me Aktgjykim të Gjykatës së Qarkut në Pejë KP.nr. 412/06 të datës 19 Shtator 2007, i konfirmuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP.nr.153/2008 të datës 12 Janar 2010 (lëndë me ankesë në shkallen e tretë) mbahet në paraburgim gjyqësor për këtë lëndë që nga data 29 Mars 2012,
2. **Dervish Idrizaj**, i lindur me 4 Maj 1984 në fshatin Kodrali, Komuna e Deçanit, i biri i \_\_\_\_\_ dhe nënës \_\_\_\_\_, mbiemri i vajzërisë \_\_\_\_\_, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, i dënuar me 5 vite burgim sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë P.nr.329/11 dhe mbahet në paraburgim gjyqësor për këtë lëndë që nga data 29 Mars 2012,
3. **Hamdi Krasniqi**, i lindur me 7 Janar 1983, në fshatin Turjakë, Komuna e Pejës, i biri \_\_\_\_\_ dhe nënës \_\_\_\_\_, mbiemri i vajzërisë \_\_\_\_\_, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, fermer, i gjendjes së mesme ekonomike dhe mbahet në paraburgim gjyqësor që nga data 17 Dhjetor 2010,
4. **Ahmet Neziraj**, i lindur me 19 Gusht 1978 në fshatin Gllogjan, Komuna e Deçanit, me banim në Pejë, rruga "Hasan Prishtina" nr. 18, i biri \_\_\_\_\_ dhe nënës \_\_\_\_\_, mbiemri i vajzërisë \_\_\_\_\_, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, oficer i policisë, i gjendjes së mesme ekonomike dhe mbahet në paraburgim gjyqësor që nga data 10 Tetor 2010,

5. **Ilmi Lufaj**, i lindur me 14 Nëntor 1980 në fshatin Strelle i Ulet, Komuna e Deçanit, i biri i dhe nënës , mbiemri i vajzërisë , Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, agjent i sigurimeve, i gjendjes së mesme ekonomike dhe është mbajtur në paraburgim gjyqësor që nga data 11 tetor 2010 deri me datën 7 Prill 2011,
6. **Himë Krasniqi**, i lindur me 7 Prill 1978 në Pejë, i biri i dhe nënës , mbiemri i vajzërisë , i martuar, baba i një fëmije, Shqiptar, shtetas i republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, vozitës, i gjendjes së mesme ekonomike dhe është mbajtur në paraburgim gjyqësor nga data 15 Tetor 2010 deri me datë 7 Prill 2011,
7. **Selman Gashi**, i lindur me 1 Dhjetor 1979 në fshatin Broliq, Komuna e Deçanit, i biri i dhe nënës , mbiemri i vajzërisë , i martuar, baba i një fëmije, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike dhe është mbajtur në paraburgim gjyqësor nga data 15 tetor 2010 deri me datë 7 Prill 2011,

të akuzuar sipas Aktakuzës së Zyrës së Prokurorisë Speciale PPS. Nr. 102/2010 të datës 31 Mars 2011, e ndryshuar me 24 Prill 2012, me këto akuza:

- sa i përket Bedri Krasniqit, Dervish Idrizaj, Hamdi Krasniqit, Ahmet Neziraj, Ilmi Lufaj, Himë Krasniqit dhe Selman Gashit nën Akuzën 1 për vepër penale *Krimi i Organizuar* në kundërshtim me Nenin 274 paragrafi 1 lidhur me veprën penale të *Kidnimit* në kundërshtim me Nenin 159 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës (ne tekstin e mëtejme "KPK");
- lidhur me Bedri Krasniqin, nën Akuzën 2.1 për vepër penale *Mbajtje në Posedim, Kontroll apo Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve* në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 3 të KPK-së dhe nën Akuzën 2.2 për vepër penale *Sulm ndaj Personit Zyrtar gjatë Kryerjes së Detyrës Zyrtare* në kundërshtim me Nenin 317 paragrafi 1 të KPK-së;
- kundër Dervish Idrizaj nën Akuzën 3 për vepër penale të *Mbajtjes në Posedim, Kontroll apo Shfrytëzim të*

Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK-së;

- sa i përket Hamdi Krasniqit nën Akuzën 4 për vepër penale të Mbajtje në Posedim, Kontroll apo Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 1 dhe 2 të KPK-së;

- dhe kundër Himë Krasniqit nën Akuzën 5 për vepër penale të Mbajtje në Posedim, Kontroll apo Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK-së;

pas mbajtjes së gjykimit publik me datë 8, 20, 21, 22, 27 Shtator, 5, 6, 11, 12 Tetor, 8, 29, 30 Nëntor, 13 Dhjetor 2011, 4, 5, 10, 11, 19, 24 Janar, 22, 28, 29 Shkurt, 12 Mars, 24, 25, 26 Prill, dhe 3 Maj 2012 ku Reshat Millaku paraqitet për Prokurori, Pala e Dëmtuar ishte i pranishëm me datë 20 Shtator 2011, Avokati Ramë Gashi paraqitej për Palën e Dëmtuar, Mahmut Halimi prezantonte për Bedri Krasniqin, Gezim Baloku prezantonte për Dervish Idrizaj, Orhan Basha prezantonte për Hamdi Krasniqin, Haxhi Cekaj dhe Klaus Kirchner prezantonin për Ahmet Neziraj, Xhelal Radoniqi prezantonte për Ilmi Lufaj, Qerim Metaj prezantonte për Himë Krasniqin dhe Gezim Kollcaku prezantonte për Selman Gashin dhe gjatë gjithë kësaj kohe të pranishëm ishin të pandehurit, pas këshillimit dhe votimit, me datë 3 Maj 2012 publikisht shpall këtë

## A K T G J Y K I M

### Nën Akuzën 1

**Të pandehurit Bedri Krasniqi, Dervish Idrizaj, Hamdi Krasniqi, Ahmet Neziraj, Ilmi Lufaj, Himë Krasniqi dhe Selman Gashi**

Janë

### **FAJTOR**

Sepse:

Me datë 21 Shtator 2010, në ora 06:05 në fshatin Gllarevë, Komuna e Klinës, të pandehurit duke vepruar si një grup i organizuar kriminal, secili me role të caktuara

paraprakisht dhe me qellim të përfitimit të paligjshëm material, dhe duke përdorur forcën dhe kërcënimin e forcës të armatosur me pistoleta dhe me një pushkë automatike AK47, kidnapuan palën e dëmtuar , gjersa ai po udhëtonte për në punë rrugës nga shtëpia e tij në në rrugën kryesore Pejë-Prishtinë. Ata detyruan veturën e , " ", të ndalej duke e goditur atë me një rënë prej veturave të tyre dhe kështu duke ia bllokuar atij udhën. Ata e rrëmbyen atë nga vetura e tij duke ia drejtuar pistoletën. Të pandehurit ia vunë atij maskën në kokë dhe pastaj me forcë e futen në bagazhin e një rënë prej veturave të tyre, e cila ishte me ngjyrë të kuqe të mbylltë e një prodhimi të panjohur. Gjate kësaj kacafytjeje rrobat e u shqyen dhe ai pësoi një lëndim në dorën e majtë. Duart iu lidhen bashkë shtrëngueshëm duke i shkaktuar lëndim. Gjatë kësaj përvoje të hidhur ishte i frikësuar për jetën e tij. Kidnapuesit udhëtuan për 10 minuta rrugës së asfaltuar dhe pastaj hyn në një rrugë me zhavorr, duke vozitur kështu më tej për afro një orë para se ta transferonin në një veturë të tipit Xhip. Kidnapuesit pastaj e dërguan në një stan barinjsh në bjeshkët e Milishevcit. Ky stan ishte i familjes Bojkaj. Gjersa po mbahej në këtë stan si peng , kidnapuesit ia morën atij orën e dorës dhe unazën. Njeri nga kidnapuesit e qëllloi atë me tytë të pistoletës në ballë dhe e kërcënoi atë se po qe se e hiqte maskën ai do të shtinte në të. u mbajt në stanin e Bojkajve deri me datë 22 Shtator 2010, kur veprimet e kidnapuesve linden dyshime tek barinjtë vendor. u dërgua me një veturë Toyota "4 Runner" me xhama të errësuar në një vend tjetër teposhtë nga kjo bjeshkë. Bedri Krasniqi erdhi në këtë vend me një veturë të zezë karavan. pastaj u morr me këtë veturë të zezë karavan tek një vend te pyllëzuar dhe aty u mbajt gjatë natës. Ditën tjetër, 23 Shtator 2010, u bart me veturën karavan të zezë teposhtë para se të transferohej në një veturë të tipit Xhip dhe të udhëtonte për afro katër orë në një shtëpi të braktisur në një vend të panjohur ku mbeti si rob. Këtu, me datë 4 Tetor 2010 dy anëtar të grupit kriminal bënë një video incizim me për të ia treguar familjes së tij. u lirua në Prishtinë vonë në mbrëmjen e datës 30 Tetor 2010, pasi që u mbajt si rob për 40 ditë gjithsej.

Bedri Krasniqi luajti rolin kryesor në këtë grup kriminal. Në mëngjesin e kidnapimit ai ishte rregullisht në kontakt me telefon mobil me Himë Krasniqin dhe Selman Gashin. Mes

orës 06:15 dhe 07:26, Bedri Krasniqi i dërgoi 9 mesazhe SMS Selman Gashit dhe pranoi 16 mesazhe SMS nga ai. Gjersa po udhëtonin nga Gllareve drejt bjeshkës së Milishevcit aparati/SIM kartela në pronësi të Selman Gashit aktivizoj të njëjtën antenë si edhe aparati/SIM kartela e poseduar nga Bedri Krasniqi. Mes orës 07:26 dhe 07:36 Bedri Krasniqi dërgoi 3 mesazhe SMS Himë Krasniqit dhe pranoi nga ai 7 mesazhe SMS. Detyra e Selman Gashit ishte të njoftonte Bedri Krasniqin për kushtet e komunikacionit në rrugë përgjatë se cilës do të transportohej . Bedri Krasniqi mu atë mëngjes ishte po ashtu në kontakt me telefon me Dervish Idrizaj. Në stanin e Bojkajve njeri nga kidnapuesit ia dha telefonin e vetë dhe e urdhëroi që të telefononte birin e tij për ta njoftuar për kidnapimin e tij dhe ta paralajmëronte të mos njoftonte policinë.

Në stanin e Bojkajve me datë 21 Shtator 2010 dhe ditën tjetër në zonën e pyllëzuar, ruhej nga Hamdi Krasniqi i cili ishte i armatosur me pushkë automatike Kallashnikov.

Me datë 22 Shtator 2010 Ahmet Neziraj përdori veturën e tij Toyota "4 Runner" për të transportuar nga stani i Bojkajve në vendin tjetër në bjeshkë para se të dërgohej në zonën e pyllëzuar me veturën karavan të zezë ku ai kaloi natën. Pas kësaj ai u dërgua në një shtëpi të braktisur. Gjatë të shumtës së kohës në këtë shtëpi të braktisur është mbajtur me sy të mbyllur.

Me datë 22 Shtator 2010 në ora 11:31 njeri nga kidnapuesit përdori telefonin mobil që e kishte huazuar nga dëshmitari D1 për të kontaktuar Ilmi Lufaj. Kidnapuesi i dha udhëzime Ilmi Lufaj lidhur me një takim në stanin e Bojkajve.

Me datë 22 Shtator 2010 gjersa ishte në stanin e Bojkajve, Bedri Krasniqi i tha se duhej të behej kërkesa e harraqit.

Me datë 4 Tetor 2010 Dervish Idrizaj dhe Himë Krasniqi bënë një video incizim me për të mbështetur kërkesën e harraqit dhe për të treguar se ishte akoma gjallë.

Bedri Krasniqi, Dervish Idrizaj, Hamdi Krasniqi, Hime Krasniqi, Ilmi Lufaj dhe Ahmet Neziraj më pas u identifikuan nga si anëtar të grupit kidnapues.

Dëshmitari D1 identifikoj Hamdi Krasniqi që kishte qenë i pranishëm në stanin e Bojkajve me datë 22 Shtator 2010 dhe identifikoi po ashtu Ahmet Neziraj si vozitësin e veturës së bardhë Toyota "4 Runner" me xhama të errëta e cila ishte përdorur për të transportuar nga stani i Bojkajve.

Gjate periudhe kohore 21 - 23 Shtator 2010 Bedri Krasniqi ishte në komunikim me telefon mobile me Ilmi Lufaj, Selman Gashi, Hime Krasniqi dhe Dervish Idrizaj. Gjate kësaj periudhe të njëjtë kohore Ilmi Lufaj ishte në komunikim me telefon mobile me Dervish Idrizaj. Gjate periudhës së njëjtë Hime Krasniqi ishte në komunikim me telefon mobile me Selman Gashi. Gjatë gjithë kësaj periudhe kohore këta të pandehur përdoren SIM kartela të ndryshme duke pasur në posedim telefona të ndryshme mobile.

Me datë 26 Shtator 2010 në ora 07:21 Bedri Krasniqi beri kërkesë tek i biri i , për pagesën e harraqit prej 3 milion Eurosh. Ai deklaroi, "nëse mendon të merremi vesh, 3 milion Euro nevojiten për të liruar babanë tuaj. Secili gabim ka me të kushtua..." kërkesa për harraq u bë nga numri i telefonit 049 643 485 duke përdorur telefonin Nokia 6300 që kishte numër të IMEI-it 135990246811220. Ky telefon mobile më pas u konfiskua nga bastisja e shtëpisë së Bedri Krasniqit në fshatin Turjak, Komuna e Pejës me datë 17 Dhjetor 2010. Kur ai beri kërkesën për harraq Bedri Krasniqi iu prezantua si 'Mali'. Komunikim në mes të 'Mali-t' dhe lidhur me pagesën e harraqit ndodhi gjatë periudhës 25 Shtator 2010 deri me datë 9 Tetor 2010, kur ra dakord të paguante harraqin prej 350.000,00 Eurosh. Është e qartë nga komunikimi me mesazhe SMS se familja po vëzhgohej nga kidnapuesit gjatë kësaj periudhe kohore. Me datë 29 Shtator, 1 Tetor dhe me datë 6 Tetor 2010 Bedri Krasniqi në veçanti kërcënoi se po qe se bashkëpunon me policinë apo nuk paguante harraqin babai i tij do të vritej dhe biznesi familjar do të shkatërrohej.

Me datë 9 Tetor 2010 rreth orës 22:00, doli nga shtëpia e tij në duke vozitur veturën e vëllait të tij me një çantë që kishte para të gatshme në shumë prej 350,000 Eurosh. Ai shoqërohej nga kushëriri i tij . Bedri Krasniqi udhëzoi përmes mesazhit SMS lidhur me rrugën që do merrte, sa shpejt të ngiste dhe kur të ndalonte. Është e qartë nga

shënimet e listingut telefonik se po vëzhgohej nga Himë Krasniqi dhe Selman Gashi kur ai doli nga shtëpia me datë 9 Tetor 2010 për të paguar harraquin. Kur ai arriti në rrethinën e Deçanit, ati iu tha të kthente në të majtë afër Marketit 'KU', për të vazhduar edhe katër kilometra të tjerë me indikator të lëshuar dhe se kur arrinte tek një monument i caktuar të hapte dritaren e veturës dhe të hidhte nga vetura çantën që kishte paratë. përcolli këto udhëzime. Por se, po përcillej nga policia. Kur kidnapuesit u munduan të kapnin çantën që kishte paratë policia u mundua ti arrestonte kidnapuesit dhe kështu pati shkëmbim zjarri. Kidnapuesit ikën me veturën Peugeot. Policia kapi paratë dhe ia ktheu

Ahmet Neziraj dhe Ilmi Lufaj u arrestuan me 10, gjegjësisht 11 Tetor 2010, ndërsa Hime Krasniqi dhe Selman Gashi që të dy u arrestuan me datë 15 Tetor 2010. Bedri Krasniqi, Dervish Idrizaj dhe Hamdi Krasniqi mbeten në arrati deri sa u arrestuan me datë 17 Dhjetor 2010.

Me datë 23 tetor 2010 kidnapuesit kontaktuan dhe e njoftuan se ishte akoma i gjallë dhe se ata donin të venin në jetë marrëveshjen mbi harraquin. Ata paralajmëruan lidhur me vazhdimin e tij për të përfshirë policinë. Bedri Krasniqi beri kërcënime të tjera për të vrarë .

Me datë 30 Tetor 2010 tërhoqi nga Nova Ljubljanska Banka shumen prej 300.000,00 euros. Me datë 1 Nëntor 2010 ktheu shumen e njëjtë prej 70.000,00 Eurosh në të njëjtën bankë.

Gjatë mbrëmjes së datës 30 Tetor 2010 u lirua në Prishtinë nga kidnapuesit.

vazhdimisht refuzoi të tregoi se a u pagua harraq për lirim e babait të tij.

Në këtë mënyrë, Bedri Krasniqi, Dervish Idrizaj, Hamdi Krasniqi, Ahmet Neziraj, Ilmi Lufaj, Himë Krasniqi dhe Selman Gashi kryen veprën penale *Krim i Organizuar* në kundërshtim me Nenin 274 paragrafi 1 lidhur me veprën penale të *Kidnapimit* në kundërshtim me Nenin 159 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës.

\* \* \*

Nen akuzën 2.1

**I pandehuri Bedri Krasniqi**

**SHPALLET FAJTOR**

Për shkak se:

Në një bastisje të shtëpisë së tij në fshatin Turjakë, Komuna e Pejës, të kryer nga Policia e Kosovës më 17 dhjetor 2010 në orën 06:30, i pandehuri Bedri Krasniqi është gjetur në posedim të dy granatave të dorës M75, një armë dore "Zastava" M57 me kalibër 7.62mm (numri serik C-210484), bashkë me 160 copë fishek municion për këtë armë, një pushkë automatike AK-47 e modelit "Zastava" (numri serik 261170) me 172 copë fishek municion për armen e njëjtë, dhe një automatik "Scorpion" me shurdhues (numri serik 10514) për të cilën ai nuk posedonte lejen për autorizim për posedim të armeve.

Prandaj, ai ka kryer veprën penale të *Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328, paragrafi 3 të KPK-së.*

Nen akuzën 2.2

Në bazë të nenit 390 par. 1 nen-par. 3 të Kodit të Procedurës Penale (ne tekstin e mëtejme "KPPK"), **i pandehuri Bedri Krasniqi**

**LIROHET**

Për shkak se:

Nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të dëshmuar përtej dyshimit të bazuar që më datën 19 tetor 2010, i pandehuri Bedri Krasniqi ka vozitur një veturë të llojit xhip Grand Cherokee me tabela të regjistrimit 515-KS-550 në drejtim të zyrtarit të policisë në mënyrë të atillë për të sulmuar atë apo për ta kërcënuar seriozisht me sulm ndaj tij.

Me të cilin rast do të kishte kryer veprën penale të Sulmit ndaj Personit Zyrtar gjatë Kryerjes së Detyrave Zyrtare në kundërshtim të nenit 317 paragrafit 1 të KPK-së.

\* \* \*

Nen akuzën 3

**I pandehuri Dervish Idrizaj,**

#### **SHPALLET FAJTOR**

Për shkak se:

Në një bastisje në shtëpinë e Bedri dhe Hamdi Krasniqit dhe ku ishte duke banuar Dervish Idrizaj gjatë asaj kohe, në fshatin Turjakë, Komuna e Pejës, e kryer nga Policia e Kosovës, më datën 17 dhjetor 2010, i pandehuri Dervish Idrizaj është gjetur në posedim të një pistolete të modelit "Argentina" të kalibrit 9mm bashkë me katërbëdhjetë copë fishek municion. I pandehuri, Dervish Idrizaj nuk kishte lejen për autorizim në posedimin armeve në atë kohë.

Prandaj, ai ka kryer veprën penale të *Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve* në kundërshtim të nenit 328, paragrafi 2 të KPK-së.

\* \* \*

Nen akuzën 4

**I pandehuri Hamdi Krasniqi**

#### **SHPALLET FAJTOR**

Për shkak se:

Përderisa ishte duke ruajtur palën e dëmtuar, Azem Morinën në stanin e Bojkajve në Bjeshkët e Milishevcit, më datën 21, 22 dhe 23 shtator 2010 i pandehuri, Hamdi Krasniqi kishte qenë në posedim të një pushke sulmi AK47, armë që ai e mbante me qellim të kërcënimit ndaj . I

pandehuri, Hamdi Krasniqi nuk kishte lejen për autorizim në posedimin e armeve në atë kohë.

Prandaj, ai ka kryer veprën penale të *Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328, paragrafi 1 të KPK-së.*

\* \* \*

#### Nen akuzën 5

#### **I pandehuri Himë Krasniqi**

#### **SHPALLET FAJTOR**

Për shkak se:

Gjatë një bastisje në shtëpinë e tij me numër 19 "Ploja e Rugovës", në Pejë, më 15 tetor 2010, Hime Krasniqi ka qenë në posedim të një pistolete të modelit Magnum 41 (numri serik A39X925MOD657) bashkë me dy copë fishek municion për këtë armë. I pandehuri, Himë Krasniqi nuk kishte lejen për autorizim në posedimin e kësaj arme.

Prandaj, ai ka kryer veprën penale të *Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328, paragrafi 2 të KPK-së*

\* \* \*

Në këtë mënyrë, në pajtim me dispozitat e neneve 6, 11, 15, 31, 32, 33, 34 pikat 1 dhe 2, nenet 36, 38, 39, par 1 dhe 2, 54 par 1 dhe 2 pikat 7, nenet 64 par 1 dhe 3, 65 par 1, 71 par 1 dhe 2, pikat 2 dhe 4, 73 par 1, 99 par 1, nenet 274 par. 1 në lidhje me nenin 159 par. 2 dhe 328 par. 1, 2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës, nenet 99 par 1 dhe 2, pikat 1, 2, 3, 4, 6 dhe 8, 102 par 1, 328 par 1, 385, 387, 391 dhe 392 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, trupi gjykues shqipton dënimet si në vijim:

#### **Ndaj Bedri Krasniqit,**

- Për veprën penale nen akuzën 1 dënohet me një afat kohor prej pesëmbëdhjetë (15) viteve burgim dhe me një gjobë prej 200.000,00 euro;

- Për veprën penale nen akuzën 2.1 dënohet me tre (3) vite burgim;
- Në bazë të nenit 71 par. 1 dhe 2 nen par. 2 të KPK-së, caktohet dënimi për bashkim të veprave penale me gjithë së bashku shtatëmbëdhjetë (17) vite burgim dhe me një gjobë prej 200.000,00 euro;

**Ndaj Dervish Idrizajt,**

- Për veprën penale nen akuzën 1 dënohet me një afat kohor prej dymbëdhjetë (12) viteve burgim dhe me një gjobë prej 180.000,00 euro.
- Për veprën penale nen akuzën 3 dënohet me një afat kohor prej dy (2) viteve burgim;
- Në bazë të nenit 71 par. 1 dhe 2 nen par. 2 të KPK-së, caktohet dënimi për bashkim të veprave penale me gjithë së bashku trembëdhjetë (13) vite burgim dhe me një gjobë prej 180.000,00 euro.

**Ndaj Hamdi Krasniqit,**

- Për veprën penale nen akuzën 1 dënohet me njëmbëdhjetë (11) vite burgim dhe me një gjobë prej 150.000,00 euro.
- Për veprën penale nen akuzën 4 dënohet me dy (2) vite burgim.
- Në bazë të nenit 71 par. 1 dhe 2 nen par. 2 të KPK-së, caktohet dënimi për bashkim të veprave penale me gjithë së bashku dymbëdhjetë (12) vite burgim dhe me një gjobë prej 150.000,00 euro.

**Ndaj Ahmet Nezirajt,**

- Për veprën penale nen akuzën 1 dënohet me pesëmbëdhjetë (15) vite burgim dhe me një gjobë prej 150.000,00 euro

**Ndaj Himë Krasniqit,**

- Për veprën penale nen akuzën 1 dënohet me dhjetë (10) vite burgim dhe me një gjobë prej 150.000,00 euro.
- Për veprën penale nen akuzën 5 dënohet me një afat kohor prej një (1) viti burgim;

- Në bazë të nenit 71 par. 1 dhe 2 nen par. 2 të KPK-së, caktohet dënimi për bashkim të veprave penale me gjithë së bashku dhjetë (10) vite e gjashtë (6) muaj burgim dhe më një gjobë prej 150.000,00 euro.

**Ndaj Selman Gashit,**

- Për veprën penale nen akuzën 1 dënohet me dhjetë (10) vite burgim dhe me një gjobë prej 150.000,00 euro

**Ndaj Ilmi Lufaj,**

- Për veprën penale nen akuzën 1 dënohet me dhjetë (10) vite burgim dhe me një gjobë prej 150.000,00 euro

Koha e kaluar në paraburgim nga të pandehurit e dënuar, Bedri Krasniqi nga data 29 mars 2012 deri më datën 03 maj 2012, Dervish Idrizaj nga data 29 mars 2012 deri më datën 03 maj 2012, Hamdi Krasniqi nga data 17 dhjetor 2010 deri më datën 03 maj 2012, Ahmet Neziraj nga data 10 tetor 2010 deri më datën 03 maj 2012, Himë Krasniqi nga data 15 tetor 2010 deri më datën 07 prill 2011, nga Selman Gashi nga data 15 tetor 2010 deri më datën 07 prill 2011 dhe nga i pandehuri Ilmi Lufaj nga data 11 tetor 2010 deri më datën 07 prill 2011, do ti zbritet dënimit të caktuar ndaj secilit prej tyre, gjegjësisht.

Në përputhje me nenin 39 të KPK-së, dënimi me gjobë i shqiptuar ndaj të pandehurve duhet të paguhet brenda tre muajve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë. Nëse ndonjëri prej të pandehurve nuk paguan gjobën, trupi gjykues do të zëvendëson gjobën me burgim.

Në përputhje me nenin 54 par. 1 dhe 3 nen-par. 7 dhe nenin 60 të KPK-së, shqiptohet dënimi plotësues i konfiskimit të armeve: dy granata dore M75, një armë dore "Zastava" M57 me kalibër 7.62mm (numër serik C-210484), me 160 copë fishek për armen e njëjtë, një pushkë automatike AK-47 "Zastava" (numri serik 261170) me 172 copë fishek për armen e njëjtë, dhe një armë automatike "Scorpion" me shurdhues (numri serik 10514) kundër të pandehurit Bedri Krasniqi. Më tej, telefoni mobil NOKIA 6300 IMEI me numër 135790246811220 (357636784280950) do të konfiskohet në mënyrë të përhershme dhe d të jetë pjesë e dosjes së rastit.

Në përputhje me nenin 54 par. 1 dhe 3 nen-par. 7 dhe nenit 60 të KPK-së, shqiptohet dënimi plotësues i konfiskimit të armës: një pistoletë e modelit "Argentina" me kalibër 9mm bashkë me katërmbëdhjetë copë fishek municion, kundër të pandehurit të dënuar Dervish Idrizaj.

Në përputhje me nenin 54 par. 1 dhe 3 nen-par. 7 dhe nenin 60 të KPK-së, vetura e llojit TOYOTA 4-runner, numri i shashise KZN1850066641, me numër të tabelave të regjistrimit 03-582-AG, (më herët 596-KS-472) pronë e Ahmet Nezirajt, nëpërmjet kësaj konfiskohet.

Në përputhje me nenin 54 par. 1 dhe 3 nen-par. 7 dhe nenin 60 të KPK-së, shqiptohet dënimi plotësues i konfiskimit të armës: një pistoletë a llojit Magnum 41 (numri serik A39X925MOD657) bashkë me dy copë fishek municion, kundër të pandehurit Himë Krasniqi.

Secili prej të pandehurve të dënuar do të paguajnë shpenzimet e procesit gjyqësor, që janë vlerësuar në shumën prej 1.000€ për secilin prej tyre, bashkë me paushallin gjyqësor në shumën prej €200 për secilin.

Pala e dëmtuar mund të parashtroj kërkesë për dëmshpërblim përmes procedurës civile.

**GJYKATA E QARKUT NË PEJË**

**Më datë 3 Maj 2012**

**P.nr.214/11**

**Procesmbajtëse**

**Natasa Malesevic**



**Kryetari i Trupit Gjyqësor**

**Malcolm Simmons**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Në bazë të nenit 400 par. 1 të KPPK-së, ankesa duhet të shpallët brenda (8) ditëve nga shpallja e këtij aktvendimi dhe duhet të parashtrohet në gjykatën e shkallës së parë.

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi në formë të shkruar, përmes Gjykatës së Qarkut në Pejë për Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data kur kopja e aktgjykimit u është dorëzuar, sipas Nenit 398, paragrafi 1 i KPPK-së.